



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1667/2 Prot.

Tiranë, më 20. 12. 2018

V E N D I M

Nr. 257, Datë 20. 12. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 183, datë 27.11.2018, e A. K., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjinisë, bindjes politike, moshës, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes civile*”¹, nga ana e Bashkisë Berat dhe Departamentit të Administratës Publike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaron se me Vendimin Nr. 796, datë 14.11.2016 është shkarkuar nga detyra në pozicionin si Shefe Finance dhe Administrate në Ndërrmarrjen e Gjellbërimit, Mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve të Bashkisë Berat me motivacionin “*Për mosdorëzim të Formularit të Vetëdeklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike*””.

¹ Në lidhje me shkaqet e pretenduara, ankuesja shpjegon se është një femër e divorcuar në moshën 50 vjeçare dhe është diskriminuar për shkak të bindjes politike pasi nuk është pjesë e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Subjekti ankues, në vijim të ankesës në mes të tjerash shprehet se: “Në mënyrë diskriminuese, arbitrare, dhe në kundërshtim me ligjin, Bashkia Berat dhe Departamenti i Administratës Publike e kanë cilësuar drejtuese e çdo niveli në administratën publike jashtë shërbimit civil dhe duke mashtruar me ligjin, duke fallsifikuar gjithë procedurën të dy institucionet përdorën ligjin e dekriminalizimit për ti marrë vendin e punës, për të punësuar nënën e funksionarit të LSI-s, A. H. i cili ka marrë pjesë direkt në këtë diskriminim dhe shpërdorim detyre dhe për të njollosur emrin e saj”.

Ankuesja, në mes të tjerash informon se: “Është evidentuar në listën e drejtuesve të qeverisjes vendore jashtë shërbimit civil sipas formatit të plotësuar nga Bashkia Berat dhe dërguar në DAP brenda datës 05.04.2016, shkresë në dispozicion të dy institucioneve, për të cilën nuk ka qenë në dijeni. Lista me emrat i është mbajtur dhe vazhdon të mbahet e fshehur nga dy institucionet, pasi mbulohet mashtrimi dhe shpifja që i është bërë. Me kërkesat datë 25.04.2017 si informim publik ka kërkuar çdo shkresë zyrtare shkresore dhe elektronike, që ka lidhje me institucionin, punonjësit lidhur me çështjen e dorëzimit të formularëve të dekriminalizimit për periudhën Janar – 04.05.2016 drejtuar DAP-it, por përgjigja mungon sepse korrespondenca është fshehur me dashje”.

Në mbështetje të pretendimeve të saj, ankuesja ka sqaruar se lidhur me veprimet dhe mosveprimet diskriminuese nga ana e Bashkisë Berat dhe Departamentit të Administratës Publike është vënë në dijeni më datë 02.08.2017. Gjithashtu, ankuesja pretendon se ka vijuar trajtimi diskriminues nga ana e këtyre institucioneve edhe gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2018, duke mos i kthyer përgjigje shkresave të saj.

Ankuesja informon se i është drejtuar në vazhdimësi të dy institucioneve për të kërkuar shpjegime dhe dokumentacion në kuadër të të drejtës së informimit, por që nuk ka marrë dokumentin që kërkon.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përvajshim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në formularin e ankesës Nr. 183, datë 27.11.2018, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të saj, Komisioneri vlerëson se, A. K. është njohur me sjelljet diskriminuese nga ana e Bashkisë Berat dhe Departamentit të Administratës Publike, për largimin nga puna që në datë 14.11.2016, periudhë kur A. K. është vënë në djeni të Vendimit Nr. 796, datë 14.11.2016 të Bashkisë Berat për shkarkimin nga detyra si Shefe Finance dhe Administrate në Ndërrmarrjen e Gjellbërimit, Mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve të Bashkisë Berat.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i dërguar në mbështetje të ankesës, evidentohet se ankuesja ka depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të njëjtat pretendime dhe prova, që ka paraqitur më parë në ankesën Nr. 63 rregj., datë 14.05.2018, për të cilën Komisioneri është shprehur me Vendimin Nr. 126, datë 23.05.2018.

Sa i përket pretendimit se diskriminimi ndaj saj, ka vijuar edhe gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2018, Komisioneri vëren se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë fakt apo argument për të provuar se situata diskriminuese e pretenduar ka vijuar edhe gjatë vitit 2018.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket mosvënies në dispozicion të shpjegimeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Bashkia Berat dhe Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. E drejta e informimit dhe vënia në dispozicion të dokumenteve bën pjesë në kompetencën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” citon shprehimisht se: ankesa nuk pranohet nëse “është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës* “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeneri për këtë sjellje”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4 b/c të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A. K., për shkak se është dhënë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.
2. Rekomandimin e subjektit ankues që pretendimin për diskriminim, ta ndjekë gjyqësisht, në zbatim të nenit 36, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Rekomandimin e subjektit ankues që bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ti drejtoheni Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: gjinia, bindjet politike, mosha, gjendja familjare, martesore dhe gjendja civile)
(Fusha: Punësim)